



AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORTI VJETOR

2024

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	3
1. Vlerësimi dhe ekzekutimi i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit ...	4
1.1.Përditësimi dhe vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare	4
1.2.Kompensimi financiar/fizik i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit	4
1.3.Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)	6
2. Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie	6
3. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim	7
4. Përfaqësimi Ligjor i ATP-së	8
5. Raportime institucionale	8
5.1.Raportime nga Asistenca Ligjore.....	9
5.2.Raportime institucionale në zbatim të Ligjit 133/2015	9
5.3. Raportime periodike mujore pranë ZOS për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis	9
6. Kërkesa/ankesa të trajtuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronave	10
6.1.Trajtimi i shkresave pranë protokollit të ATP-së.....	10
6.2.Trajtimi i kërkesave/ankesave pranë ATP-së	10
6.2.1. Trajtimi i kërkesave/ankesave nga portali i Bashkëqeverisjes	10
6.2.2. Dokumente të trajtuar nga Sektori i Arkivës.....	10
6.3.Shërbime elektronike të ofruara nga ATP	11
7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompensimit.....	12
7.1.Analiza e Buxhetit të vitit 2024 (pa kuadruar nga Thesari).....	12
7.2.Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP	14
7.3.Informacioni shpenzime për Aluiznin dhe Kompensim Financiar, dhe me raste të veçanta	15

Hyrje

Agjencia e Trajtimit të Pronave është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe ushtron aktivitetin e saj në zbatim të Ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore VKM-në Nr. 221/2016; VKM-në Nr. 222/2016, i ndryshuar dhe VKM-në Nr. 223/2016, i ndryshuar.

Ligji 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e kompensimit të pronave” është miratuar në dt. 05.12.2015 dhe ka hyrë në fuqi në dt. 23.02.2016 duke përcaktuar një afat 3-vjeçar për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare dhe për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie nga hyrja në fuqi e ligjit dhe një afat 10-vjeçar për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që janë vlerësuar financiarisht.

Me zbardhjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 15.02.2021, procesi i kompensimit financiar për vendimet përfundimtare në Agjencinë e Trajtimit të Pronave u pezullua dhe filloi puna për ndryshimet e ligjit nr. 133/2015.

Ligji nr. 77/2022, datë 17.11.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” u botua në Fletoren Zyrtare nr. 168, datë 15.12.2022. Ndryshimet ligjore siguruan zgjatjen e afatit për trajtimin e kërkesave për njohje pronësie si dhe vlerësimin financiar të vendimeve të kompensimit deri në datën 31.12.2024. Këto ndryshime diktuan edhe nevojën për ndërhyrjen në aktet nënligjore të cilat u miratuan në Maj të vitit 2023, ku u ndryshuan respektivisht vendimet Nr. 223/2016 dhe Nr. 222/2016 të Këshillit të Ministrave.

Në bazë e për zbatim të ndryshimeve të miratuara, u bë i mundur vlerësimi financiar sipas rekomandimeve të dhëna nga GjEDNj për 3919 vendime me të drejtë kompensimi që kishin pësuar ndryshim të zërit kadastral, me një faturë të shtuar financiare prej rreth 16,015,625,979.13 lekë, si dhe u rivendos juridiksioni administrativ për trajtimin e dosjeve/praktikave të patrajuara me vendim brenda afateve të përcaktuara në nenin 34 të Ligjit 133/2015. Për 6596 vendime të tjera të cilat kishin pësuar ndryshim të zërit kadastral, nuk pati ndryshim të vlerës së publikuar për arsye të ndryshme (*vendime për të cilat vlera sipas ligjit 133/2015 ishte më e madhe se sa vlera sipas ndryshimeve ligjore, vendime vetëm me të drejte parablerje, vendime me vlerë të përcaktuar në vendim etj*).

Në mbledhjen e datës 08.11.2023, Gjykata Kushtetuese, pasi mori në shqyrtim paraprak çështjen me nr. 18 (K) 2023 të Regjistrat Themeltar, me kërkes Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin e disa pikave të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022, vendosi pezullimin e zbatimit të këtij ligji, si dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

Kjo masë procedurale, solli si pasojë pezullimin e plotë të proceseve të punës në ATP për një periudhë 3 mujore. Kjo vendimarrje e Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera, pati një efekt tejet demotivues, duke reduktuar ndjeshëm numrin e dosjeve të rikthyera për shqyrtim në ATP, krahas efektit financiar, ku fondit të kompensimit i'u shkaktua një dëm prej 2.34 mld lekë.

Gjykata Kushtetuese në datë 13.02.2024 vendosi rrëzimin e kërkesës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe ATP rifilloi punën normalisht. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka marrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme ligjore për vijueshmërinë normale të procedurave administrative institucionale, ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka marrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme ligjore për vijueshmërinë normale të procedurave administrative institucionale, ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore. Përditësimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATP-së kryesisht www.atp.gov.al.

Agjencia e Trajtimit të Pronave, në zbatim të pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 221, datë 23.3.2016, “Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave“, paraqet raportin vjetor të punës për periudhën janar – dhjetor 2024.

1. Vlerësimi dhe ekzekutimi i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave, nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në mbylljen e procesit të vlerësimit, ka ndërmarrë procedurat administrative të vlerësimit financiar për **27 023 vendime** përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013. Të gjitha përditësimet janë bërë publike në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

1.1. Përditësimi dhe vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare

- **20,532 vendime** u vlerësuan financiarisht, nga të cilat **915 vendime** u vlerësuan gjatë vitit 2024. Nga këto të fundit, 536 janë me vlerë positive 4,298,056,137 lekë dhe 73 rezultojnë me vlerë negative -647,043,914 lekë. Ndërsa për 306 vendime pritet plotësimi i dokumentacionit nga ana e subjekteve.
- Vlera totale e vendimeve me të drejtë kompensimi të vlerësuar financiarisht është **121,046,905,205.74 lekë** (vlera pritet të ndryshojë pasi ATP është në pritje të përfundimit të ankimeve nga subjektet në bazë të afateve ligjore);
- **3126 vendime** ku nuk është përcaktuar se ku bie parablerja;
- **2532 vendime** për të cilat subjekti konsiderohet i kompensuar, vlera prej - **27,783,163,951.37 lekë**;
- **833 vendimet** e fshira gjatë procesit të rivlerësimit të vendimeve;
- **3,919 vendimet** e prekura nga ndryshimet ligjore dhe fatura financiare është rritur me **16,015,625,979.13 lekë** pas ndryshimeve ligjore.

1.2. Kompensimi financiar/fizik i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit

Nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015, janë depozituar **2,570 kërkesa** për kompensim financiar dhe fizik, nga të cilat janë ekzekutuar **33.85%**, përkatësisht **870 vendime**, me një vlerë totale prej **8,414,526,544.07 lekë**. Nga këto, **87 vendime** janë mbyllje procedimi, ndërsa është shpërndarë gjithashtu një sipërfaqe prej **765 ha** tokë nga fondi fizik. Pjesa e mbetur e kërkesave nuk është ekzekutuar kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm, vonesave nga ndryshimet ligjore, mungesën e deklaratave noteriale, problematika të lidhura me tagrin e prokurave dhe çështje të tjera administrative që kanë penguar përfundimin e procedurave ligjore.



Evidencë e ndarjes demografike të vendimeve për kompensim

Forma e kompensimit	Sek. i kompensimit 1*	Sek. i kompensimit 2*	Totali
Kompensim me skemën 20/80	270	282	552
Kompensim me kërkesë të veçantë	215	103	318
Totali	485	385	870

*1 - Sektori i kompensimit financiar/fizik dhe me kërkesë të veçantë për qarqet Tiranë, Berat, Shkodër, Kukës, Lezhë dhe Dibër.

*2 - Sektori i kompensimit financiar/fizik dhe me kërkesë të veçantë për qarqet Korçë, Vlorë, Elbasan, Fier, Durrës dhe Gjirokastrë.

Gjatë vitit 2024, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar me procesin e kompensimit financiar dhe fizik, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi përmes mekanizmave të përcaktuar për kompensim dhe rezultton:

Gjatë periudhës **janar – dhjetor 2024**, për Kompensimin Financiar dhe Fizik dhe Kompensim me Kërkesë Veçantë, rezultton:


Kompensim deri në 1,500,000 lekë	
Nr. i vendimeve të ekzekutuara	24
Vlera e ekzekutuar	18,618,191.92 lekë
Kompensim me kërkesë të veçantë 40%	
Nr. i vendimeve të ekzekutuara	23
Përfitimi total për subjektet	487,031,286.52 lekë
Kësti i parë i ekzekutuar	98,852,787.70 lekë
Vlera e kursyer për buxhetin e shtetit	803,112,459.27 lekë
Nr. i dosjeve që përfitojnë këstet e rradhës	74
Vlera e ekzekutuar për këstet e rradhës	219,410,760.86 lekë
Mbyllje procedimi administrativ	1
Nr. i dosjeve të reja të pranuar	21
Kompensim financiar dhe fizik 20/80	
Nr. i vendimeve të ekzekutuara	5
Vlera e ekzekutuar	15,966,617.20 lekë
Vlera e përfituar fizikisht	75,560,952.82 lekë
Sipërfaqja e kompensuar fizikisht	46.86 ha
Mbyllje procedimi administrativ	5
Nr. i dosjeve të reja të pranuar	90

1.3. Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)

Në zbatim të VKM-së nr. 383 datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale”, të ndryshuar, që prej fillimit të procesit janë miratuar 86 VKM në bazë të së cilave miratohen listat e subjekteve përfituese dhe pasurive përkatëse. Sipërfaqja e trajtuar nga këto VKM është 3,648,761.08 m². Pranë ATP-së janë administruar kërkesat e 13,760 subjekteve për përfitim të kompensimit, nga të cilat 9,713 janë subjekte përfituese, pra 70.6% të totalit.


Përgjatë vitit 2024 janë miratuar 7 VKM dhe janë paraqitur 1039 aplikime nga subjektet. ATP kreu ekzekutimin e kështit të fundit në masë 30% për 5320 dosje, vlera e të cilave shkon në 3,095,139,163.84 lekë. Gjatë vitit 2024 janë ekzekutuar 636 aplikime në masë 70% me vlerë 952,289,280.62 lekë.

Evidencë e trajtimit të aplikimeve për kompensim nga ALUIZNI gjatë vitit 2024



2. Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie

ATP ka regjistruar në total **16 462** kërkesa të depozituara me ligjet e mëparshme dhe kërkesa të reja sipas ligjit 133/2015. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022, afati i përcaktuar në nenin 34 pika 1 ka ndryshuar. Neni i cili më parë parashikonte se nëse ATP nuk përmbushte detyrimin për të trajtuar kërkesat në afatin 3-vjeçar, subjektet mund të drejtoheshin gjykatës së shkallës së parë për trajtimin e tyre, tani është ndryshuar duke vendosur një afat trajtimi brenda datës 31.12.2024. Në këto kushte, ATP-ja vazhdon të trajtojë dosjet dhe kërkesat e subjekteve, përfshirë ato të patërhequra, të tërhequra dhe ato që i janë drejtuar gjykatës, në përputhje me dispozitat e nenit 34, pika 2 të ligjit 133/2015, i ndryshuar.



Nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, ATP ka dhënë **293 vendime** për njohje pronësie.

Për periudhën **janar – dhjetor 2024**, rezulton se:

- Janë dhënë **230 vendime** për njohje pronësie;
- Janë dërguar **1000 njoftime** për plotësim dokumentacioni, dhe subjektet kanë depozituar **478 dokumentacione** në dosjet ekzistuese.
- Janë rikthyer në ATP **366 dosje/praktika**;
- Janë në trajtim **6840 dosje/praktika**.

Gjatë vitit 2024, ATP ka trajtuar me vendim dosjet sipas qarqeve:

Qarku	Nr. i vendimeve
Berat	1
Durrës	50
Dibër	1
Elbasan	8
Fier	41
Gjirokastrë	27
Korçë	18
Kukës	8
Shkodër	12
Tiranë	4
Vlorë	60

3. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim

Për periudhën janar – dhjetor 2024, Sektori i Verifikimit të Fondit Fizik në zbatim të nenit 12, të ligjit 133/2015, “*Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave*” të ndryshuar, ka kryer këtë veprimtari:

Në lidhje me verifikimin e fondit fizik, pas plotësimit me konfirmimet mbi statusin juridik të pasurive dhe bllokimin në favor të ATP-së, procese këto të kryera në bashkëpunim me ASHK, është vijuar korrespondenca me Njësitë e Qeverisjes Vendore që nuk kishin sjellë më parë informacion mbi ndarjen e pasurive të paluajtshme sipas ligjit 7501/1991 dhe VKM-së nr. 770/2014.

Gjithashtu, është realizuar korrespondenca me institucione dhe subjekte private për fondin fizik në dispozicion të ATP, si për numra pasurie me interes për zhvillim/ndryshim, ashtu edhe për ato në proces kompensimi për subjektet e shpronësuara me vendime përfundimtare.

Në zbatim të VKM-së nr.926/2014 dhe akteve pararendëse, është kryer verifikimi në terren për 145 objekte shtetërore të kaluara në dispozicion të ATP-së në dhjetë qarqe dhe janë përgatitur akt-verifikimet përkatëse, duke u saktësuar në to dhe problematikat e hasura gjatë këtij procesi.

ATP ka bashkëpunuar me ASIG për korrigjimin e mospërputhjeve mes numrave të pasurive në fondin fizik të tokës bujqësore, të pasqyruar në shtresën (layer) hartografike “Fond i Kompensimit Fizik” me ngjyrë të kuqe, me numrat e pasurisë në shtresën (layer) hartografike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të pasqyruara këto dy shtresa (layer) në sistemin hartografik të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor, dhe jemi në fazën përmbyllëse të këtij procesi.

Në lidhje me pasurimin e fondit fizik, në zbatim të VKM-së nr.1077/2008, janë siguruar hartat e disa ekonomive pyjore në bashkëpunim me institucione shtetërore dhe ka filluar procesi i hedhjes së tyre në Web-GIS, sipas formateve të kërkuara nga ASHK. Janë përgatitur 29 plan-vendosje për ekonomi pyjore në Qarkun e Tiranës dhe janë dërguar DVASHK për konfirmim dhe vijimin e procedurave për regjistrimin fillestar të tyre dhe bllokimin në favor të ATP-së. Gjithashtu, ka vijuar procesi i përpilimit të plan-vendosjeve për ekonomi të tjera pyjore dhe dixhitalizimi i hartave të ekonomive pyjore në Web-GIS.

4. Përfaqësimi Ligjor i ATP-së

Një nga veprimtaritë e ATP-së është dhe mbrojtja e interesave të saj në tre shkallët e gjyqësorit dhe në gjykatën Administrative për vendimet e dhëna ndër vite. Nga Përfaqësimi Ligjor pranë gjykatave të Republikës së Shqipërisë, rezulton:

- Çështje në ndjekje në total: 2050
- Çështje në ndjekje në rrethin e Tiranës: 674
- Çështje në ndjekje në rrethet e tjera të RSH: 1376

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2024 rezulton se:

- Janë depozituar **280 padi** në të gjitha gjykatat e vendit;
- Janë mbyllur me vendim **305 padi**;
- Janë rrëzuar **79 padi**;
- Kanë përfunduar me kthimin e akteve apo me pushimin e padis **128 padi**;
- Janë ushtruar **44 ankime** dhe **33 rekurse**, total 77.

Duke patur në vëmendje ndryshimet ligjore dhe kryesisht të akteve nënligjore që përcaktojnë procedurat dhe rregullat e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e pronës të dhënat e mësipërme mund të konsiderohen si një ecuri pozitive e veprimtarisë së përfaqësimit ligjor pranë gjykatave dhe në veçanti në juridiksionin administrativ.

5. Raportime institucionale

Agjencia e Trajtimit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Avokaturën e Shtetit,

Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

5.1. Raportime nga Asistenca Ligjore

Gjatë periudhës raportuese, janë regjistruar gjithsej **322 kërkesa zyrtare**, të cilat kanë pasur për qëllim marrjen e informacionit mbi çështje të ndryshme ligjore, si më poshtë:

Institucioni	Nr. i kërkesave
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve	52
Agjencia Shtetërore e Kadastrës	217
Bashkitë	12
Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Dega e Shoqërive Publike	17
Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Dega e Shoqërive Publike	2
Gjykatat	11
Kryeministria	3
Avokatura e Shtetit	6
Bashkimi i Sindikatave të Pavarura	2
Spektori i Përfaqësimit Ligjor	154
Totali i kërkesave të trajtuara për vitin 2024	476

5.2. Raportime institucionale në zbatim të Ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave, si vijon:

- Raportim periodik institucional pranë Ministrisë së Drejtësisë, Kryeministrit dhe Kuvendit sipas përcaktimit në ligjin 133/2015;
- Kontributi i ATP-së në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”;
- Raportim në ZOS (Zyra Operacionale për Situatën) në Kryeministri për indikatorët e shërbime ndaj qytetarëve si dhe indikatorët skanime/hartografime;
- Kontributi i ATP-së mbi Takimin e 15-të të Nënkomitetit për "Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet”;
- Raportim mbi ecurinë e zbatueshmërisë së masave lidhur me monitorimin e Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës;
- Kontributi i ATP-së për raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2024;
- Raportim pranë Ministrisë së Financave në lidhje me Due Diligence;

5.3. Raportime periodike mujore pranë ZOS për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis

Nga evidencat e raportimeve mujore pranë ZOS, për periudhën **janar – dhjetor 2024**, rezulton se janë kryer **3366 skanime** të vendimeve si dhe **1970 hartografime**.

Indikatori	3M I	3M II	3M III	3M IV	Total
Skanime	24	20	93	3229	3366
Hartografime	6	1	182	1781	1970

Shënim: Hartografimet kryhen në moment që ka kërkesa nga subjektet për saktësim harte të vendimit përkatës.

6. Kërkesa/ankesa të trajtuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronave

6.1. Trajtimi i shkresave pranë protokollit të ATP-së

Për periudhën **janar – dhjetor 2024**, nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese:

Indikatori	Treguesit statistikor	janar - dhjetor 2024
Trajtimi i shkresave në ATP	Nr. i shkresave hyrëse qytetare	5494
	Nr. i shkresave hyrëse zyrtare	5899
	Nr. i shkresave me përgjigje qytetare	3806
	Nr. i shkresave me përgjigje zyrtare	4492
	Nr. i shkresave të brendshme	2594

6.2. Trajtimi i kërkesave/ankesave pranë ATP-së

6.2.1. Trajtimi i kërkesave/ankesave nga portali i Bashkëqeverisjes

Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar kërkesat dhe ankesat të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.

Për periudhën **janar – dhjetor 2024**, janë trajtuar me përgjigje **183 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, të trajtuara me përgjigje, nga të cilat:

- 50 kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e Kompensimit Financiar/Fizik;
- 98 kërkesë/ankesa për procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensimin në vlerë të ish pronarëve, tokat e të cilëve janë zënë me ndërtime informale;
- 12 kërkesë/ankesa për Sektorin e Arkivës dhe Sherbimet Online;
- 19 kërkesë/ankesa për Sektorin e Shqyrtimit;
- 4 kërkesa për Drejtorinë Juridike/ Përfaqësimin ligjor.

6.2.2. Dokumente të trajtuar nga Sektori i Arkivës

Në Arkivën e ATP-së për periudhën **janar – dhjetor 2024** rezulton se janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **1555 dosje dhe praktika** të cilat kanë zbritur në arkiv nga sektorët dhe janë hedhur në sistemin Web-GIS, të detajuara si vijon:

- 376 aplikime zyrtare;
- 379 aplikime të depozituara nga qytetarët;
- 788 aplikime në e-albania.

Janë realizuar përgjigjet e 1525 aplikimeve, nga të cilat:

- 345 aplikime zyrtare;
- 386 aplikime të depozituara nga qytetarët;
- 808 aplikime në e-albania.

6.3. Shërbime elektronike të ofruara nga ATP

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional të ATP-së me AKSHI-n dhe ADISA për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve elektronike nga portali qeveritar e-albania, ATP ka vijuar punën me shërbimet elektronike të bëra publike:

- ▶ **Nga Portali e-Albania (AMS)**, janë trajtuar **1818 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet platformës e-Albania, nga të cilat:
 - **1048 Ankesa** dhe trajtim i dosjes me specilistin përkatës;
 - **770 Kërkesa** për statusin dhe problematikat e dosjes.
- ▶ **Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE)**

Nuk ka patur aplikime zyrtare në SQDNE nga institucionet.

- ▶ Janë trajtuar **217 kërkesë/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet platformës së **Bashkëqeverisjes**.
- ▶ Stafi i ATP-së, si përdorues i Portalit Qeveritar “ONE STOP SHOP” merret me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe akseson nga sistemi dokumente si çertifikata për qytetarët.

Evidencë e shkresave/kërkesave/ankesave qytetare në ATP, janar - dhjetor 2024

Indikatori	janar - dhjetor 2024
Shkresa qytetare në protokoll	5494
Aplikime qytetare në arkivë	379
Kërkesë/ankesa nga portali i Bashkëqeverisjes	183
Kërkesë/ankesa nga portali e-albania	1818
Shkresa trajtuar me SQDNE	0

Përgjatë vitit 2024, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar procesin e identifikimit dhe përcaktimit të shërbimeve të tjera që do t'i ofrohen qytetarëve në mënyrë elektronike nga portali i Bashkëqeverisjes dhe e-albania. Nga stafi i ATP-së vazhdon të punohet bazuar në

Manualin e Përdorimit të vendosur në dispozicion nga AKSHI “Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik”.

7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompensimit

7.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2024 (pa kuadruar nga Thesari)

Nr	Emertime	Llog. Ekonomike.	Buxheti 2024	Buxheti Viti 2024 # AN nr.5, dt.19.12.2024	Fakti 12 - Mujor, Viti 2024	Realizimi në %
1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	600	219,622,000	179,622,000	176,088,292	98%
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	601	36,676,000	30,676,000	29,182,618	95%
3	Mallra dhe shërbime të tjera	602	56,400,000	56,316,000	33,019,081	59%
4	Transferime korrente të brendshme	604	4,095,140,000	4,095,140,000	4,095,140,000	100%
5	Transferata për Buxhetet familiare (Fondi Veçante))	606	284,000	284,000	163,071	57%
6	Shpenz. Për rrjetin e aktiveve të Trupëzuara	231	3,000,000	3,000,000	1,225,440	41%
7	Te Ardhura nga Vkm të tjera			234,032	234,032.00	100%
	Totali Buxhetor 1		4,411,122,000	4,365,272,032	4,335,052,534	99%
1	Te Ardhura Jashtë Buxhetore		905,000,000	778,282,157.26	778,282,157.26	86%
	Totali Jashte Buxhetore 2		905,000,000	778,282,157	778,282,157.26	
	TOTAL Buxhetore dhe Jashte Buxhetore (Total 1+Total 2)		5,316,122,000	5,143,554,189	5,113,334,691.26	

Analiza e buxhetit 12 mujor 2024 pas hyrjes në fuqi të Aktit Normativ nr. 05, datë 19.12.2024 vijon si më poshtë:

Buxheti i ATP-së për vitin 2024 është miratuar në bazë të ligjit Nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, ku u planifikua buxheti në vlerën 4,411,122,000 lekë, ndërsa u alokua në fakt 4,335,052,534 lekë. Përgjatë periudhës së raportimit plani u realizua në masën 99%.

Shpenzimet Buxhetore për 12-mujorin e vitit 2024 (pa kuadruar nga Thesari):

Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli (artikulli 600), të ndryshuar me Akt Normativ nr.5, dt.19.12.2024

- Plani për Vitin 2024 është 179,622,000 lekë.
- Fakti për Vitin 2024 është 176,088,292 lekë.

Si rrjedhojë e mosplotësimit të organikës, plani u realizua në masën 98%.

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (artikulli 601), të ndryshuar me Akt Normativ nr.5, dt.19.12.2024

- Plani për Vitin 2024 është 30,676,000 lekë.
- Fakti për Vitin 2024 është 29,182,618 lekë.

Kemi një realizim në masën 95% , për arsye mosplotësimi i organikës.

Mallra dhe shërbime të tjera (artikulli 602)

- Plani për Vitin 2024 është 56,616,000 lekë.
- Fakti për Vitin 2024 është 33,019,081 lekë.

Kemi një realizim në masën 59%.

Realizimi në masën 59%, si rrjedhojë:

1. Tek zëri ekonomik 602.0 “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, kemi një realizim në masën 55% si pasojë e mosrealizimit të fondit prej 4,500,000 lekë “Blerje tonerash” nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara brenda vitit 2024, mos realizimi i fondit prej 330,000 lekë “Blerje kuti Arkive” nga Operatori i Blerjeve Arkiva e Shtetit dhe Fonde të lira nga prokurimi.
2. Tek zëri ekonomik 602.1 “Materiale dhe shërbime speciale” kemi një realizim në masën 16%, si pasojë e mosrealizimit të proqedurës së prokurimit të “Materiale dhe pajisje të tjera dezinfektimi”, pasi jemi të detyruar ta lëmë fondin në rastë se kemi një valë infeksioni të lartë gripal (Covid), e cila nuk lindi nevoja të përdorej deri në fund të vitit 2024 .
3. Tek zëri ekonomik 602.2 “Shërbime nga të tretët”, kemi një realizim në masën 71%, si pasojë e mos realizimit të vlerës prej 4,544,916 lekë të cilët jemi detyruar të lëmë për konfirmimet në Kadastër dhe fonde të lira nga shërbimet dritat, uji, telefoni fiks dhe posta.
4. Tek zëri ekonomik 602.9 “Shpenzime të tjera operative”, kemi një realizim në masën 29%. Kemi një realizim në masën 62 % të pagës së këshilltarit (Shpenzime për honorare), kemi në realizim nën 17% të vendime gjyqësore për likujdim dhe nuk ka lindur nevoja të përdorej fondi prej 720,000 lekë “Shpenzime Operative të tjera”, raste emergjente.

Transferime korrente të brendshme (artikulli 604)

Plani për vitin 2024 ishte 4,095,000,000 lekë:

- Plani për Vitin 2024 është 4,095,000,000 lekë.
- Fakti për Vitin 2023 është 4,095,000,000 lekë.

Kemi një realizim në masën 100%.

Transferime korrente të brendshme (Të ardhura nga shitja – tokë, troje e terene, të ardhura të cilat kanë hyrë gjatë vitit 2024) (artikulli 604)

- Plani 12- Mujo 2024 është 234,032 lekë.
- Fakti 12- Mujo 2024 është 234,032 lekë.

Kemi një realizim prej 100%, ky fond i shtohet fondit special të kompensimit në Bankën e Shqipërisë.

Transferta për Buxhetet familiare Fondi Veçantë (artikulli 606)

- Plani për Vitin 2024 është 284,000 lekë.
- Fakti për Vitin 2024 është 163,071 lekë.

Kemi një realizim në masën prej 57%.

Shpenzime për rritjen e aktiveve të Trupëzuara (artikulli 231)

- Plani për Vitin 2024 është 3,000,000 lekë.
- Fakti për Vitin 2024 është 1,225,000 lekë.

Si procedurë prokurimi është realizuar në masën 100%, diferenca fonde të lira 1,774,560 lekë, të cilat derdhen në buxhet të shtetit.

Të ardhurat jashtë Buxhetore

- Plani për Vitin 2024 është 904,000,000.00 lekë.
- Fakti për Vitin 2024 është 778,282,157.26 lekë.

Kemi një realizim në masë 86%.

Shuma prej 1 miliard lekë është miratuar në bazë të ligjit nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”. Këto të ardhurat transferohen nga ASHK në llogari të ATP-së. Gjatë vitit 2024 shuma prej 778,282,157.26 lekë është transferuar nga ASHK dhe përdorur nga ATP për kompensimin e pronarëve për pronat e zëna nga ndërtimet informale, deri në masën 70%.

7.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Total	Komente
1	Tarifa për Aktet - Administrative	7110105	3,777,080.00	Perjudha 12 Mujore
2	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	7111099		
3	Të ardhura të krijuara nga pagesa e vlerës së llogaritur të tokës	7109901		
4	Të ardhura nga kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtëshme e të truallit funksional të tyre	7109902		
5	Të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore dhe objekteve të kthyera në banesa me fondet e shoqërive shtetërore	7109903		
6	Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene	1161110	234,032	Perjudha 12 Mujore
7	Të tjera	7115499		
8	Te ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndertimeve pa leje 70%	7116101	706,894,705.35	Perjudha 12 Mujore
9	Te ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndertimeve pa leje 50%	7116102	126,334,766.50	Perjudha 12 Mujore
TOTAL			837,240,583.85	

Informacioni për të ardhurat janë të pa kuadruar nga thesari: Tarifa për Aktet - Administrative

Totali 3+4+5+6+7	234,032	Të ardhura që i shtohen ATP në fondin e kompensimit, në pritje për kalimin në thesar për në bankën e Shqipërisë ritja e Autorizuar.
Totali 8+9	833,229,471.85	Të ardhura që i shtohen ATP për kompensimin e pronarëve për tokat e zëna nga ndërtimet informale (Ahuizni), për vitin 2024

- Tarifa për Aktet – Administrative Llogaria ekonomike 7110105 – 3,777,080 lekë derdhen në Buxhet të Shtetit.
- Të ardhura nga shitja - tokë, troje e terrene. Llogaria ekonomike 1161110 – 234,032 lekë. Për këtë shumë është bërë tërheqje e autorizuar dhe i shtohet fondit special për kompensimin e pronarëve sipas ligjit 133/2015, të ndryshuar.

- Të ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndërtimeve pa leje 70%. Llogaria ekonomike 7116101 – 706,894,705.33 lekë.
- Të ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndërtimeve pa leje 50%. Llogaria ekonomike 7116102 – 126,334,766.50 lekë.
- Llogaria ekonomike 7116101 dhe 7116102 në total shuma prej 833,229,471.85 lekë do ti shtohet ATP-së për kompensimin e pronarëve për tokat e zëna nga ndërtimet informale (Aluizni), për vitin 2024.

7.3. Informacioni shpenzime për Aluiznin dhe Kompensim Financiar, dhe me raste të veçanta

Totali	1,305,137,639.04	Nr. i subjekteve
Xhirime Aluzini	952,289,280.62	636
Raste Te vecanta	318,263,548.56	97
Kompensim financiar 20 me 80	15,966,617.20	5
Kompensim financiar në masë 100%	18,618,192.66	24

Gjatë vitit 2024 rezultton:

- Janë kompensuar 97 Subjekte me Kërkesë të Veçantë me vlerën prej 318,263,548.56 lekë.
- Janë kompensuar 5 Subjekt Kompensim Financiar 20 me 80 me vlerën prej 15,966,617.20 lekë.
- Janë kompensuar 24 Subjekte Kompensim Financiar në masën 100% me vlerën prej 18,618,192.66 lekë.
- Janë kompensuar 636 Subjekte që kanë përfituar kompensim që preken nga ndërtimet informale në masë 70% me vlerën prej 952,289,280.62 lekë (ALUIZNI).
- Nga Buxheti i Shtetit u dha një fond prej 3,095,140,000 lekë për të kompensuar në masën 30% subjekte që preken nga ndërtimet informale.

Me Vendimin nr. 223, dt. 30.12.2024 “Lista e subjekteve, që përfitojnë kështu e fundit (30%) të kompensimit/shpërblimit, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, ku janë kompensuar 5320 subjekte me vlerën 3,095,139,163.84 lekë, por likuidimi në bankën e nivelit të dytë u bë në dt. 07.01.2025.